



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.15, datë 02. 05. 2012

PËR

“MIRATIMIN E VLERËS MAKSIMALE TË BONUSIT TË STREHIMIT PËR TRE ZONA TË QYTETIT TË TIRANËS PËR FAMILJET NË NEVOJË PËR STREHIM”

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, nenit 10, pika 3/I, shkronja “g”, nenit 32, shkronja “k”, të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”(i ndryshuar); neneve 11, 13, 14, 15, 16 të ligjit nr.9232, datë 13.05.2004, për “Programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane” (i ndryshuar) dhe udhëzimit nr.23, datë 30.12.2008 për “Përmbajtjen e bonusit të strehimit” dhe sipas relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

1. Të miratojë vlerën maksimale të Bonusit të Strehimit, sipas zonave dhe hartës bashkëlidhur:

Për Zonën A	16 870	lekë në muaj
Për Zonën B	11 790	lekë në muaj
Për Zonën C	6 960	lekë në muaj

2. Të revokohet VKB nr.14, datë 17.07.2009 për “Miratimin e vlerës maksimale të bonusit të strehimit për familjet në nevojë”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit të Strehimit dhe Shërbimit Social, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

Niazi KOSOVRASTI